



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1138 Prot.

Rrogozhinë, më 20.03.2024


NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Martë datë 26.03.2024 ora 13:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.02.2024.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit në Bashkinë Rrogozhinë”.
(Pikë e mbartur, shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse).
- 6- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
(Pikë e mbartur, shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse).
- 7- Informim i Këshillit mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.
- 8- Shqyrtim dhe diskutim me përfaqësues-in/it e projektit, “Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar” në Bashkinë Rrogozhinë, mbi ecurinë e punës dhe sfidat e hasura në zbatimin e këtij projekti përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023.
- 9- Të ndryshme.
 - Shqyrtim i informacionit dhe shprehjes së mendimit të ardhur nga Administratori i Njësisë Lekaj, mbi kërkesën e z. U. Bermeta banor i fshatit Zanbishë Njësia Administrative Lekaj për ndihmë financiare për shkak të dëmit të shkaktuar nga zjarri në fermën e tij.
 - Të tjera.

(vijon)

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mblihet ditën e Hënë datë 25.03.2024 ora 10 : 30^o, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla -Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- Njoftoj të mblihet ditën e Hënë datë 25.03.2024 ora 11 : 00^o, Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjen Sociale, me këtë përbërje: Silvana Aliu - Kryetare, Fatmira Thartori -Zëvendëskryetare, Alime Hoxha - Anëtare, Fatbardha Sina - Anëtare, Lije Dedej - Anëtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com